

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.435, date 25.6.2004

**PER KRITERET DHE MASEN E KOMPENSIMIT TE USHTARAKUT TE
FORCAVE TE ARMATOSURA TE REPUBLIKES SE SHOIPERISE, KUR
EMEROHET OSE KOMANDOHEHET NE DETYRE JASHTE VENDBANIMIT TE TIJ**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 25, te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakut te Forcave te Armatosura qe per nevoja sherbimi emerohet me detyre jashte vendbanimit te tij te perhershem dhe ne te njejten kobe transferon edhe familjen, Ministria e Mbrojtjes i siguron transportin falas te familjes dhe te oriendive shtepiake me mjetet e saj.
 2. Ushtarakut aktiv te Forcave te Armatosura qe komandohet ne nje detyre tjeter jashte vendbanimit te tij te perhershem dhe nuk i sigurohet transporti i perditshem, i sigurohet fjetja ne shtepite e ushtarakeve.
- Shpenzimet e fjetjes te perballohen ne masen 100 per qind nga struktura ku ai eshte i komanduar.
3. Ne rastet kur nuk mund t'i sigurohet fjetja ne keto mjedise, ushtaraku perfiton nje kompensim per fjetje per ditet efektive te punes, te cilat paguhen sipas dokumenteve te paraqitura, por jo me teper se 2 000 (dy mije) leke per çdo nate.
 4. Per vajtjet dhe kthimin nga familja, ushtarakut te komanduar i paguhen shpenzimet e udhetimit per nje here ne jave sipas dokumenteve te paraqitura, por ne vlere jo me te madhe se çmimet e miratuara per linjen perkatese te autobusit.
 5. Ne rastet e fatkeqesive te personave ne ngarkim te tij, ushtarakut i mundesohet udhetime per ne familje me mjetet e njesive apo te repartit ku eshte i komanduar ose i kompensohet vlera e udhetimit.
 6. Efektet financiare qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi te perballohen nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes.
 7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes te nxjerre udhezimin perkates ne zbatim te ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

MINISTRI I MBROJTJES
PANDELI MAJKO

